(c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të

Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijoje me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i mirëmbajtjes së automjeteve dhe makinerive në administrim të Autoritetit Kontraktor do të përfshijë furnizimin me pjesë këmbimi, materiale konsumuese dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, sipas nevojave të evidentuara për secilin mjet.

Pjesët e këmbimit, materialet dhe shërbimet duhet të jenë të përshtatshme dhe kompatibël me markën, modelin, vitin e prodhimit dhe karakteristikat teknike të secilit mjet, si dhe të përmbushin kërkesat e prodhuesit ose standarde teknike ekuivalente.

Për çdo pjesë këmbimi të furnizuar, operatori ekonomik duhet të garantojë përputhshmërinë teknike me mjetin përkatës dhe funksionimin normal pas instalimit. Pjesët duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të përshtatshme për përdorim në automjete dhe makineri të kategorisë përkatëse, përveç rasteve kur në dokumentet e kontratës parashikohet ndryshe.

1. Mirëmbajtja periodike

Mirëmbajtja periodike do të përfshijë, sipas rastit dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor:

- zëvendësimin e vajit të motorit;

-
- zëvendësimin e filtrit të vajit;
 - zëvendësimin e filtrit të ajrit;
 - zëvendësimin e filtrit të karburantit/naftës;
 - zëvendësimin e filtrit të kabinës/kondicionerit;
 - kontrollin e sistemit të frenimit;
 - kontrollin e sistemit të drejtimit dhe paralelizmit;
 - kontrollin e sistemit të ftohjes;
 - kontrollin e sistemit elektrik;
 - kontrollin e sistemit hidraulik për makineritë;
 - kontrollin dhe plotësimin/zëvendësimin e vajrave teknikë;
 - lubrifikimin me graso të pikave të përcaktuara nga prodhuesi;
 - kontrollin e gjendjes së gomave;
 - kontrollin e baterive dhe sistemit të karikimit;
 - diagnostikimin e defekteve dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme.

2. Riparimet dhe ndërhyrjet teknike

Në kuadër të kontratës do të kryhen edhe ndërhyrje të nevojshme për rikthimin e mjeteve në gjendje normale pune, të cilat mund të përfshijnë:

- riparime të sistemit të frenimit;
- zëvendësim të elementeve të frenave;
- zëvendësim të disqeve të frenave;
- riparim dhe mirëmbajtje të sistemit të kondicionimit;
- riparim të motorit;
- riparim dhe mirëmbajtje të sistemit të transmisionit;
- zëvendësim të kitit të friksionit;
- riparim të sistemit të drejtimit;
- zëvendësim të kokave të paralelit dhe elementeve të tjera të drejtimit;
- zëvendësim të gomave;
- zëvendësim të baterive;
- riparim dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik;
- zëvendësim të tubove hidraulikë;
- zëvendësim të pistonëve dhe elementeve të sistemit hidraulik;
- riparime të tjera mekanike, elektrike ose hidraulike që rezultojnë të nevojshme gjatë diagnostikimit të mjetit.

3. Vajrat dhe materialet lubrifikuese

Vajrat e motorit, vajrat e transmisionit dhe vajrat hidraulikë duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të mjetit përkatës.

Në mënyrë të veçantë, për mjetet dhe makineritë do të përdoren, sipas specifikimeve të prodhuesit:

- vaj motori;
- vaj transmisioni;
- vaj diferenciali/80W-90 ose ekuivalent teknik;
- vaj hidraulik ISO VG 68 ose ekuivalent, sipas kërkesës së pajisjes;
- graso për përdorim mekanik dhe industrial.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë që viskoziteti, klasifikimi dhe specifikimet teknike të vajrave të jenë të përshtatshme për motorin, transmisionin ose sistemin hidraulik ku do të përdoren.

4. Filtrat

Filtrat e vajit, ajrit, naftës, kabinës, kondicionerit dhe kompresorit të ajrit duhet:

- të jenë të rinj dhe të papërdorur;
- të jenë kompatibël me mjetin përkatës;
- të përmbushin parametrat teknikë të kërkuar nga prodhuesi;
- të sigurojnë filtrimin e nevojshëm dhe funksionimin normal të sistemit përkatës.

5. Sistemi i frenimit

Pjesët dhe shërbimet që lidhen me sistemin e frenimit duhet të garantojnë funksionimin e sigurt të mjetit.

Në varësi të nevojës, mund të përfshihen:

- elemente frenimi para dhe pas;
- disqe frenash;
- pompa frenash;
- elemente të tjera të sistemit të frenimit.

Pas kryerjes së ndërhyrjes, operatori ekonomik duhet të kontrollojë funksionimin e sistemit të frenimit dhe të sigurojë që mjeti të jetë i përshtatshëm për t'u rikthyer në përdorim.

6. Gomat

Gomat duhet të jenë të reja dhe të përshtatshme për llojin e automjetit ose makinerisë, duke respektuar:

- dimensionet e kërkuara;
- indeksin e ngarkesës;
- indeksin e shpejtësisë, kur aplikohet;
- tipologjinë e përdorimit;
- kushtet e punës dhe terrenin ku përdoret mjeti.

Gomat duhet të jenë të përshtatshme për përdorim të sigurt dhe të përmbushin standardet teknike të aplikueshme.

7. Mirëmbajtja e makinerive të rënda

Për fadromat, eskavatorët dhe makineritë e tjera të punës, mirëmbajtja do të përfshijë, sipas nevojës:

- zëvendësimin e vajit të motorit;
- zëvendësimin e filtrave;
- kontrollin dhe zëvendësimin e vajit hidraulik;
- zëvendësimin e tubove hidraulikë;
- kontrollin e pistonëve dhe cilindrave hidraulikë;
- lubrifikimin e nyjeve dhe pikave të përcaktuara të grasimit;
- kontrollin e sistemit hidraulik;
- kontrollin e sistemit të transmetimit;
- riparimin ose zëvendësimin e komponentëve të dëmtuar;
- shërbime të tjera mekanike dhe hidraulike të nevojshme për funksionimin normal të makinerive.

8. Kërkesa për cilësinë e shërbimit

Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e shërbimeve.

Shërbimet duhet të kryhen nga personel teknik i kualifikuar dhe me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme për llojin e ndërhyrjes.

Çdo ndërhyrje duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë dëmtime të mëtejshme në automjet ose makineri.

Pas përfundimit të shërbimit, mjeti duhet të dorëzohet në gjendje të përshtatshme për përdorim dhe, kur ndërhyrja e kërkon, të kryhet kontrolli funksional i tij.

9. Diagnostikimi dhe përcaktimi i ndërhyrjeve

Për defektet që nuk mund të përcaktohen paraprakisht, operatori ekonomik duhet të kryejë diagnostikimin e nevojshëm teknik.

Në rast se gjatë diagnostikimit evidentohen nevoja të tjera për pjesë këmbimi ose shërbime që nuk janë të përcaktuara fillimisht, ndërhyrja do të realizohet vetëm pas kërkesës/miratimit të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me kushtet e kontratës.

10. Lista e mjeteve

Lista e mjeteve të përfshira në mirëmbajtje është si më poshtë:

Nr.	Mjeti	Viti	Karburanti	Targa
1	Mitsubishi	2021	Naftë	AB 149 FE
2	Mercedes Benz Atego	2016	Naftë	AB 842 DL
3	Iveco	2024	Naftë	AB 780 VL
4	Hidromek Fadrom ARMT	2025	Naftë	—
5	Iveco	2018	Naftë	AB 788 XJ
6	Mitsubishi	2020	Naftë	AB 143 BO
7	Iveco	2019	Naftë	AB 116 ZB
8	Kamion me kazan	2010	Naftë	AB 218 ZR
9	Mitsubishi L200	2009	Naftë	AA 709 UX
10	Fadromë	2024	Naftë	AS MT 64
11	Eskavator me zinxhir Volvo	—	Naftë	—

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

I. MITSUBISHI – AB 149 FE

Të dhënat identifikuese:

- Marka: Mitsubishi
- Targa: AB 149 FE
- Viti: 2021
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- MMCJJKL60NH003797

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	10
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter naftë	Copë	1
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Frena para	Copë	1
7	Frena pas	Copë	1
8	Disqe frenave para	Copë	2
9	Koka paraleli	Copë	2
10	Vaj 75Ë80	L	10
11	Goma	Copë	4
12	Kovergjencë	Shërbim	1
13	Riparim kondicioneri	Shërbim	1

II. MERCEDES BENZ ATEGO – AB 842 DL

Të dhënat identifikuese:

- Marka/Modeli: Mercedes Benz Atego
- Targa: AB 842 DL
- Viti: 2016
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- WDB96702210071634

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	30
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	1
5	Filter kabine	Copë	1
6	Filter kompresori ajri	Copë	1
7	Vaj 80W90	L	30

III. KAMIONCIN IVECO – AB 780 VL

Të dhënat identifikuese:

- Marka: Iveco
- Targa: AB 780 VL
- Viti: 2024
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- ZCFCE35B605671243

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	12
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	2
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Pompë frenash	Copë	1
7	Frena para	Copë	1
8	Frena pas	Copë	1

IV. HIDROMEK FADROM ARMT

Të dhënat identifikuese:

- Marka/Modeli: Hidromek – Fadrom ARMT
- Viti: 2025
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- HMK62SSSV2C000827

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	15
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	2

4	Filter nafte	Copë	2
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Vaj hidrauliku	L	50
7	Tubo hidrauliku	Copë	5
8	Graso	Kg	6

V. KAMIONCIN IVECO – AB 788 XJ

Të dhënat identifikuese:

- Marka: Iveco
- Targa: AB 788 XJ
- Viti: 2018
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- ZCFCD35A105244966

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	12
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	2
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Pompë frenash	Copë	1
7	Frena para	Copë	1
8	Frena pas	Copë	1
9	Kit freksioni	Copë	1

VI. MITSUBISHI – AB 143 BO

Të dhënat identifikuese:

- Marka: Mitsubishi
- Targa: AB 143 BO
- Viti: 2020
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- MMCJJKL60LH132300

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	10
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	1
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Frena para	Copë	1

7	Frena pas	Copë	1
8	Disqe frenave pas	Copë	2
9	Vaj 75W80	L	10
10	Kit freksioni	Copë	1
11	Bateri 100 AM	Copë	1

VII. KAMIONCINË IVECO – AB 116 ZB

Të dhënat identifikuese:

- Marka: Iveco
- Targa: AB 116 ZB
- Viti: 2019
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- ZCFC250D405271842

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	12
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	2
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Pompë frenash	Copë	1
7	Frena para	Copë	1
8	Frena pas	Copë	1
9	Goma	Copë	4

VIII. KAMION ME KAZAN – AB 218 ZR

Të dhënat identifikuese:

- Targa: AB 218 ZR
- Viti: 2010
- Ngjyra: E bardhë
- Karburanti: Naftë
- WMAN08ZZ2AY243367

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	40
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	1
5	Filter kabine	Copë	1

6	Filter kompresori ajri	Copë	1
7	Vaj hidrauliku ISO 68	L	40
8	Goma para	Copë	2
9	Frena para	Copë	1
10	Goma pas	Copë	2

IX. MITSUBISHI L200

Të dhënat identifikuese:

- Marka/Modeli: Mitsubishi L200
- Targa: AA709UX
- Viti: 2009
- Ngjyra: Gri
- Karburanti: Naftë

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	10
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter ajri	Copë	1
4	Filter nafte	Copë	1
5	Filter kondicioneri	Copë	1
6	Riparim motori	Shërbim	1
7	Goma	Copë	4
8	Bateri 100 AM	Copë	1
9	Frena para	Copë	1
10	Stopa pas	Copë	2

X. FADROMË – AS MT 64

Të dhënat identifikuese:

- Targa: AS MT 64
- Viti: 2024
- Ngjyra: E verdhë
- Karburanti: Naftë
- KMTWB024CRUF65128

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motori	L	14
2	Filter vaji	Copë	1
3	Filter nafte	Copë	1
4	Filter ajri	Copë	2
5	Tubo hidrauliku	Copë	2
6	Vaj hidrauliku	L	50

7	Graso	Kg	10
---	-------	----	----

XI. ESKAVATOR ME ZINXHIR – VOLVO

Të dhënat identifikuese:

- Lloji: Eskavator me zinxhir
- Marka: Volvo
- Karburanti: Naftë

Pjesët dhe shërbimet e nevojshme:

Nr.	Pjesa/Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Piston kollone	Copë	1
2	Tubo vaji	Copë	5
3	Vaj hidrauliku	L	100
4	Graso	Kg	30

Afatet e ekzekutimit: Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, nga lidhja e kontratës/kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

Qëllimi i këtij shërbimi është garantimi i gjendjes së mirë teknike, funksionimit normal, sigurisë dhe gatishmërisë së vazhdueshme të automjeteve dhe makinerive në administrim të Autoritetit Kontraktor, të cilat përdoren për realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike. Shërbimi do të përfshijë furnizimin me pjesë këmbimi, materiale konsumuese, vajra, lubrifikantë dhe materiale të tjera të nevojshme, si dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes periodike, diagnostikimit, riparimit dhe ndërhyrjeve teknike, sipas nevojave konkrete të secilit mjet.

Qëllimi kryesor i shërbimit është:

- garantimi i funksionimit normal dhe të sigurt të automjeteve dhe makinerive;
- siguri i gatishmërisë së flotës për kryerjen e shërbimeve publike;
- parandalimi i defekteve dhe dëmtimeve të mëtejshme;
- reduktimi i kohës së qëndrimit të mjeteve jashtë përdorimit;
- rritja e jetëgjatësisë së automjeteve dhe makinerive;
- garantimi i sigurisë së punonjësve gjatë përdorimit të mjeteve;
- ulja e kostove që mund të krijohen nga defektet e paparashikuara dhe ndërhyrjet e vonuara;
- garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike që realizohen nga Autoriteti Kontraktor.

Pjesët e këmbimit dhe materialet e përdorura duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe teknikisht të përshtatshme me mjetin përkatës. Ato duhet të jenë kompatibël me markën, modelin, vitin e prodhimit dhe karakteristikat teknike të mjetit dhe të përmbushin kërkesat e prodhuesit ose standarde teknike ekuivalente.

2. Detyrat

Operatori Ekonomik, në kuadër të realizimit të shërbimit, do të ketë për detyrë të kryejë mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe riparimin e automjeteve dhe makinerive sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në mënyrë të veçantë, detyrat do të përfshijnë:

2.1. Mirëmbajtjen periodike

- kontrollin teknik periodik të mjeteve;
- zëvendësimin e vajit të motorit;
- zëvendësimin e filtrave të vajit, ajrit, naftës, kabinës dhe kondicionerit;
- kontrollin e sistemit të frenimit;
- kontrollin e sistemit të drejtimit dhe paralelizmit;
- kontrollin e sistemit të ftohjes;
- kontrollin e sistemit elektrik;
- kontrollin e baterive dhe sistemit të karikimit;
- kontrollin e sistemit hidraulik të makinerive;
- kontrollin dhe zëvendësimin e vajrave teknikë;
- lubrifikimin me graso;
- kontrollin e gjendjes së gomave;
- diagnostikimin e defekteve dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme.

2.2. Riparimet dhe ndërhyrjet teknike

Operatori Ekonomik do të kryejë, sipas nevojës:

- riparimin e sistemit të frenimit;
- zëvendësimin e elementeve të frenave dhe disqeve;
- riparimin e motorit;
- mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të kondicionimit;
- mirëmbajtjen e transmisionit;
- zëvendësimin e kitit të friksionit;
- riparimin e sistemit të drejtimit;
- zëvendësimin e kokave të paralelit;
- zëvendësimin e gomave;
- zëvendësimin e baterive;
- riparimin e sistemeve elektrike;
- riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike;
- zëvendësimin e tubove hidraulikë;
- zëvendësimin e pistonëve dhe komponentëve hidraulikë;
- kryerjen e çdo ndërhyrjeje tjetër mekanike, elektrike ose hidraulike që rezulton e nevojshme pas diagnostikimit.

2.3. Diagnostikimi

Për çdo defekt të konstatuar, operatori ekonomik duhet të kryejë diagnostikimin teknik të nevojshëm dhe të përcaktojë shkakun e defektit dhe ndërhyrjen e nevojshme.

Kur gjatë diagnostikimit evidentohen nevoja për pjesë këmbimi ose shërbime shtesë nga ato të parashikuara fillimisht, ato do të realizohen vetëm pas kërkesës dhe miratimit të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me kushtet e kontratës.

2.4. Kërkesat për pjesët dhe materialet

Operatori ekonomik duhet të sigurojë:

- pjesë këmbimi të reja dhe të papërdorura;
- pjesë të përshtatshme dhe kompatibël me mjetin;
- vajra dhe lubrifikantë sipas specifikimeve teknike të mjetit;
- filtra që përmbushin parametrat teknikë të kërkuar;
- goma të përshtatshme për llojin dhe përdorimin e mjetit;
- materiale dhe komponentë të përshtatshëm për makineritë e rënda.

2.5. Kontrolli pas ndërhyrjes

Pas përfundimit të çdo riparimi ose mirëmbajtjeje, operatori ekonomik duhet të kryejë kontrollin funksional të mjetit dhe të sigurojë që ai të jetë në gjendje të përshtatshme teknike për t'u rikthyer në përdorim.

Në rastin e ndërhyrjeve në sistemin e frenimit, drejtimit, sistemit hidraulik ose komponentëve të tjerë që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë, kontrolli pas ndërhyrjes duhet të jetë i detyrueshëm.

3. Shpërndarja

Shërbimet dhe furnizimi me pjesë këmbimi e materiale do të realizohen sipas nevojave konkrete të mjeteve dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor, brenda periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

Shpërndarja e pjesëve të këmbimit dhe materialeve do të bëhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe në përputhje me preventivin dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e procedurës.

Për çdo ndërhyrje, Autoriteti Kontraktor do t'i komunikojë operatorit ekonomik nevojën për shërbim, duke përcaktuar mjetin, defektin ose shërbimin e kërkuar.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe materialeve të nevojshme për realizimin e shërbimit dhe të organizojë ndërhyrjen brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet kur nevoja për ndërhyrje është urgjente dhe lidhet me rikthimin e një mjeti në funksion për kryerjen e shërbimeve publike, operatori ekonomik duhet të mobilizojë pa vonesë kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore.

Shpërndarja dhe furnizimi duhet të kryhen në mënyrë që të garantohet vazhdimësia e mirëmbajtjes dhe minimizimi i kohës së qëndrimit të mjeteve jashtë përdorimit.

4. Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve

Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit do të kryhen në ambientet/servisin e operatorit ekonomik, i cili duhet të disponojë kapacitetet, pajisjet dhe kushtet teknike të nevojshme për realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Në varësi të natyrës së defektit dhe nevojës së Autoritetit Kontraktor, ndërhyrjet mund të kryhen edhe në vendndodhjen e mjetit, kur kjo është teknikisht e mundur dhe kur transportimi i mjetit në servis nuk është i nevojshëm.

Pjesët e këmbimit dhe materialet do të dorëzohen dhe instalohen në kuadër të realizimit të shërbimit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Pas përfundimit të shërbimit, automjeti ose makineria duhet të dorëzohet në gjendje të përshtatshme teknike dhe funksionale për përdorim.

Dorëzimi i mjetit pas mirëmbajtjes ose riparimit do të shoqërohet, sipas rastit, me informacion mbi ndërhyrjen e kryer, pjesët e zëvendësuara dhe materialet e përdorura.

Operatori ekonomik mban përgjegjësi për cilësinë dhe përputhshmërinë e pjesëve të furnizuara dhe për cilësinë e shërbimeve të kryera, në përputhje me kushtet e kontratës.

Vendi i realizimit të shërbimeve: ambientet e servisit të Operatorit Ekonomik dhe, kur është teknikisht e mundur dhe kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, vendndodhja e automjetit/makinerisë në administrim të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme, të lëshuar nga QKB, Kodi VII.3.B.1, për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, që mbulon shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike, të motorit, sistemit elektrik dhe gomave, në përputhje me objektin e kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 3 (tre) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Listëpagesës sipas formularit standart për sigurimet për muajin Gusht 2026.

Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Gusht 2026.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon një servis të licencuar për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor, i cili ndodhet në një distancë jo më të madhe se 50 (pesëdhjetë) km nga qyteti i Himarës (distanca prej 50 km do të konsiderohet si distancë rrugore nga qyteti i Himarës deri në adresën e servisit të deklaruar nga Operatori Ekonomik).

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, në pronësi ose nëpërmjet një forme të ligjshme përdorimi, të paktën 1 (një) karroatrec, i cili do të jetë në dispozicion gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për transportimin/tërheqjen e automjeteve të Autoritetit Kontraktor në rast defekti, avarie ose pamundësie për të lëvizur në mënyrë autonome.

Karroatreci duhet të jetë i përshtatshëm për transportin dhe tërheqjen e kategorive të automjeteve objekt të shërbimit të mirëmbajtjes dhe të plotësojë kërkesat teknike dhe ligjore përkatëse për qarkullim dhe përdorim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon pronësinë ose disponimin e ligjshëm të mjetit, si dhe dokumentacionin e vlefshëm të mjetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se karroatreci nuk është në pronësi të operatorit ekonomik, disponimi i tij mund të dëshmohet nëpërmjet kontratës së qirasë, huapërdorjes, marrëveshjes së bashkëpunimit ose dokumenti tjetër të vlefshëm juridik, nga i cili rezulton qartë e drejta e operatorit ekonomik për përdorimin e mjetit gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që karroatreci të jetë në dispozicion për nevojat e Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, të paktën 2 (dy) gropa shërbimi për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, me gjatësi minimale 10 (dhjetë) metra secila, të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve objekt të kontratës.

